

UDHËZIM
Nr.29/1, datë 16.8.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË KRYEN AGJENCIA
PUBLIKE E AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 8.3.2013)

(I përditësuar)

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 60, të nenit 61 dhe nenit 62 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 14 të vendimit nr.424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave

UDHËZOJNË:

1. Tarifa për shërbimet që kryhen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) me angazhim të ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj, për vlerësimin paraprak të programeve të studimit të jenë si më poshtë në lekë:

Vlerësimet	Tarifa-ekspert vendas	Tarifa-ekspertizë e huaj në distancë	Tarifa-ekspertizë e huaj-prezent
<i>a) revokuar me vendimin nr. 7, datë 8.3.2013</i>			
b) vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të parë	193,000	338,000	589,000
c) vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të dytë	204,000	533,000	659,000
<i>ç) revokuar me vendimin nr. 7, datë 8.3.2013</i>			

2. Tarifat për shërbimet që kryen Agjencia Publike e akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) me angazhimin e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj, për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin të jenë si më poshtë në lekë:

Vlerësimet		Tarifat
a)	Vlerësimi i jashtëm dhe akredimi institucional i institucionit të arsimit të lartë/filial (ose akreditimi i parë) 1. Një institucion me 1-2 fakultete, filial	1,128,000
	2. Një universitet me 3-5 fakultete ose filial me 3-5 fakultete	1,965,000
	3. Një kolegji profesional	376.000

b)	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të parë	
	1. Me angazhim të ekspertëve vendas	288,000
	2. Me angazhim të ekspertëve të huaj	578,000
c)	Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të dytë	
	1. Me angazhim të ekspertëve vendas	304,000
	2. Me angazhim të ekspertëve të huaj	632,000
ç)	<i>Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i Shkollës Doktorale dhe i një programi studimi të ciklit të tretë:</i>	552.000
	1. Tarifa për akreditim ose vlerësim paraprak (shkenca sociale e humane)	
	2. Tarifa për akreditim ose vlerësim me ekspertë të huaj (fusha mjekësore dhe shkenca natyrore)	602.000
	3. Tarifa për akreditim ose vlerësim të Shkollës Doktorale (njësi bazë), duke përfshirë të gjitha programet e ciklit të tretë që ofron kjo Shkollë Doktorale	Ekspertë vendas dhe të huaj 1.180.400
d)	<i>Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi profesional me kohëzgjatje 2 (dy) vjet:</i> <i>Tarifa për vlerësimin ose akreditimin e një programi të ciklit të shkurtër 2-vjeçar profesional</i>	45.000

3. Tarifat për shërbimet që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) me angazhim të ekspertëve për shërbime që nuk përfshihen në pikat 1 dhe 2, si për riorganizimin, ristrukturimin apo shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për hapjen e njësive të jenë si më poshtë në lekë:

Vlerësimet	Tarifat
1.Vlerësimi i aplikimit për riorganizimin e programeve të studimit	93,000
2.Vlerësimi i aplikimit për ristrukturimin e institucionit	93,000
3.Vlerësimi i kërkesës për hapjen e një njësie në institucionet e arsimit të lartë	93,000
4.Konsulenca të Agjencisë të Akreditimit të Arsimit të Lartë që nuk përfshihen në kategoritë e lartëpërmendura	93,000

4. Kur pas vlerësimit paraprak në varësi të pikës 1 të këtij udhëzimi (pikat a-ç) ose pas vlerësimit të jashtëm, në varësi të pikës 2 të këtij udhëzimi (pikat a-ç), Këshilli i Akreditimit ose Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, respektivisht sipas kompetencave, vendos kushte për vlerësimin paraprak përfundimtar apo për akreditimin përfundimtar pozitiv dhe nëse institucionit i duhet t'i nënshtrohet sërish procesit të vlerësimit paraprak

apo vlerësimit të jashtëm, subjekti paguan sërish por vetëm 35% të tarifës të përcaktuar në varësi të pikave 1 dhe 2 të këtij udhëzimi (pikat a-ç).

5. Tarifa për çdo vlerësim, e llogaritur sipas pikës 1 të këtij udhëzimi arkëtohet para fillimit të procesit të vlerësimit në APAAL, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyra të postës shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

6. Tarifa për çdo vlerësim, e llogaritur sipas pikës 2 dhe 3 të këtij udhëzimi, arkëtohet para fillimit të procesit të aplikimit në APAAL, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyra të postës shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

7. Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë shpërndahen 10% në Buxhetin e Shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë.

8. Pjesa e të ardhurave që i takon Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë evidentohet, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në kapitullin 06, "Të ardhurat jashtë limitit".

9. Të ardhurat që sigurohen nga këto shërbime për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë përdoren si më poshtë:

a) për pagesat e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj, dhe konsulentëve, të cilët janë kontraktuar nga APAAL;

b) për të mbuluar shpenzimet operative dhe të funksionimit të Këshillit të Akreditimit;

c) për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizata ose institucione ndërkombëtare;

ç) për pagesën e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit dhe shpenzimet e tjera të tij;

10. Institucionet e arsimit të lartë të cilët kanë aplikuar për shërbimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi dhe nuk kanë paguar tarifat e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.2, datë 18.1.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave "Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike", do të paguajnë tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim.

11. Udhëzimi i përbashkët nr.2, datë 18.1.2011 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave "Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike", shfuqizohet.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode